

## **Drejtor i Përgjithshëm AZHBR**

### **Ardita Kuçi**

Ardita Kuçi ka lindur në Berat më 10 prill 1988.

Ajo zotëron një Diplomë të Nivelit të Dytë të Integruar në Drejtësi nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku është specializuar në disa fusha të drejtësisë, duke përfshirë të Drejtën Civile, Penale, Publike, Administrative, të Punës, të Drejtat Evropiane, Private dhe Komeriale. Më tej ka thelluar ekspertizën e saj ligjore duke marrë titullin Avokat në Dhomën Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë në vitin 2011.

Ajo ka një përvojë të pasur në fushën e drejtësisë dhe menaxhimit të projekteve sidomos në sektorët e zhvillimit bujqësor dhe rural. Aktualisht, ajo shërben edhe si Drejtoreshë e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit në AZHBR, një pozicion që e mban që nga nëntori 2022.

Përpara këtij pozicioni ka qenë Përgjegjëse e Sektorit Juridik në të njëjtën agjenci nga shtatori 2019 deri në nëntor 2022. Në këtë kapacitet, ajo ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe rishikimin e kudit të ri ligjor, përgatitjen e akteve administrative dhe kontratave, zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe ofrimin e mbështetjes ligjore për të gjitha departamentet brenda agjencisë.

Gjithashtu, nga dhjetori 2017 deri në shtator 2019, znj. Kuçi ka shërbyer si Përgjegjëse e Sektorit të Përputhshmërisë Acquis dhe Asistencës së Jashtme në Agjencinë IPARD. Gjatë kësaj periudhe ka koordinuar proceset e akreditimit të Programit IPARD II dhe harmonizimit të procedurave bazuar në legjislacionin e BE-së dhe atë kombëtar.

Znj. Kuçi ka mbajtur më herët edhe pozicione menaxheriale në Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe sektorin privat.

Gjatë gjithë karrierës së saj profesionale, znj. Kuçi ka kryer një serë trajnimesh dhe kulifikimesh mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, Menaxhimin e Granteve dhe Prokurimin dhe Kontraktimin sipas Procedurave të BE-së, Luftën Kundër Korrupsionit, Thithjen e Investimeve të Huaja në fushën e Instrumentit të Para-Antaresimit IPA.

Ajo zotëron disa gjuhë te huaja, duke përfshirë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht.